LIGJ
Nr. 6/2020

PËR PRANIMIN E INSTRUMENTIT TË AMENDAMENTIT TË KUSHTETUTËS SË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS, 1986

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pranimin e instrumentit të amendamentit të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.2.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11434, datë 14.2.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

INSTRUMENTI PËR NDRYSHIMIN E KUSHTETUTËS SË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS 1986

TEKSTI AUTENTIK

INSTRUMENTI PËR NDRYSHIMIN E KUSHTETUTËS SË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS[1]

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e thirrur në Gjenevë nga organi qeverisës i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe e mbledhur në sesionin e saj të shtatëdhjetë e dy, më 4 qershor 1986, dhe, pasi vendosi miratimin e disa ndryshimeve të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, çështje e cila është përfshirë në pikën e shtatë të rendit të ditës së sesionit, miraton, në ditën e njëzet e katërt të qershorit, të vitit njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë, instrumentin e mëposhtëm për ndryshimin e Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, i cili mund të citohet si Instrumenti i Amendamentit të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986.

[1] Miratuar nga Konferenca më 24 qershor 1986, me 352 vota pro 44 kundër, asnjë abstenim.

Neni 1

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Instrumenti të Amendamentit, dispozitat e Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, për të cilat teksti i tanishëm në fuqi është përcaktuar në kolonën e parë të shtojcës së këtij instrumenti, ka efekt, të ndryshuar në kolonën e dytë të shtojcës në fjalë.

Neni 2

Dy kopje të këtij instrumenti të amendamentit duhet të vërtetohen me nënshkrimet e presidentit të Konferencës dhe të drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës. Një nga këto kopje duhet të depozitohet në arkivat e Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe tjetra duhet t'i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Drejtori i përgjithshëm do t'u dërgojë një kopje të vërtetuar të instrumentit të gjithë anëtarëve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 3

1. Ratifikimi zyrtar ose pranimi i këtij instrumenti të amendamentit duhet t'i dërgohet drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, i cili duhet të njoftojë anëtarët e Organizatës për marrjen e saj.
2. Ky instrument i amendamentit do të hyjë në fuqi, në përputhje me dispozitat e nenit 36 të Kushtetutës së Organizatës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij instrumenti, drejtori i përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet të njoftojë për këtë të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

SHTOJCA
KUSHTETUTA E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS

Dispozitat në fuqi më 24 qershor 1986[2]	Dispozitat e amenduara[2]
Neni 1	Neni 1
4. Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mund të pranojë, gjithashtu, anëtarët e organizatës, me një votë pro nga dy të tretat e përfaqësuesve që marrin pjesë në sesion, duke përfshirë dy të tretat e përfaqësuesve të qeverisë [të pranishëm dhe] në votim. Një pranim i tillë hyn në fuqi me komunikatën drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës nga qeveria e anëtarit të ri, në lidhje me pranimin e tij zyrtar të detyrimeve të Kushtetutës së Organizatës.	4. Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mund të pranojë, gjithashtu, anëtarët e Organizatës, me një votë pro nga dy të tretat e përfaqësuesve që marrin pjesë në sesion, duke përfshirë dy të tretat e përfaqësuesve të qeverisë që kanë marrë pjesë në votim. Një pranim i tillë hyn në fuqi me komunikatën drejtuar Zyrës Ndërkombëtare të Punës nga qeveria e anëtarit të ri, në lidhje me pranimin e saj zyrtar të detyrimeve të Kushtetutës së Organizatës.
Neni 3	Neni 3
9. Kredencialet e përfaqësuesve dhe të këshilltarëve të tyre i nënshtrohen shqyrtimit nga Konferenca, e cila, me dy të tretat e votave të paraqitura [nga përfaqësuesit e pranishëm], mund të refuzojë pranimin e ndonjë përfaqësuesi ose këshilltari të cilin e konsideron të mos jetë emëruar në pajtim me këtë nen.	9. Kredencialet e përfaqësuesve dhe këshilltarëve të tyre i nënshtrohen shqyrtimit nga Konferenca, e cila, me dy të tretat e votave të paraqitura, mund të refuzojë pranimin e ndonjë përfaqësuesi ose këshilltari të cilin e konsideron të mos jetë emëruar në pajtim me këtë nen.
Neni 6	Neni 6
Çdo ndryshim i selisë së Zyrës Ndërkombëtare të Punës vendoset nga Konferenca me shumicën e dy të tretave të votave të paraqitura [nga përfaqësuesit e pranishëm].	Çdo ndryshim i selisë së Zyrës Ndërkombëtare të Punës vendoset nga Konferenca me shumicën e dy të tretave të votave të paraqitura.
Neni 7	Neni 7
1. Organi qeverisës përbëhet nga pesëdhjetë e gjashtë persona: Njëzet e tetë që përfaqësojnë qeveritë; Katërmbëdhjetë që përfaqësojnë punëdhënësit; dhe Katërmbëdhjetë që përfaqësojnë punonjësit.	1. Organi qeverisës përfshin njëqind e dymbëdhjetë vende: - pesëdhjetë e gjashtë vende për personat që përfaqësojnë qeveritë; - njëzet e tetë vende për personat që përfaqësojnë punëdhënësit; dhe - njëzet e tetë vende për personat që

[2] Fjalët e fshira nga dispozitat në fuqi, në datën 24 qershor 1986, vendosen në kllapa katrore. Ndryshimet dhe shtesat e paraqitura nga dispozitat e amendura, janë nënvizuar.

	përfaqësojnë punëtorët.
2. Nga njëzet e tetë persona që përfaqësojnë qeveritë, dhjetë emërohen nga anëtarët me rëndësi të madhe industriale dhe tetëmbëdhjetë emërohen nga anëtarët e përzgjedhur për atë qëllim nga përfaqësuesit e qeverisë në Konferencë, duke përjashtuar përfaqësuesit e dhjetë anëtarëve të përmendur sa më lart.	2. Përbërja e tij duhet të jetë sa më përfaqësuese që të jetë e mundur, duke pasur parasysh interesat e ndryshëm gjeografikë, ekonomikë dhe socialë, brenda tri grupeve përbërëse, megjithatë, pa cenuar autonominë e njohur të këtyre grupeve.
3. Organi qeverisës, kur kërkohet, sipas rastit, vendos se cilët janë anëtarët e Organizatës me rëndësi të madhe industriale dhe harton rregulla për t'u siguruar se të gjitha çështjet lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve me rëndësi të madhe industriale shqyrtohen nga një komitet i paanshëm përpara se të vendosen nga organi qeverisës. Çdo kërkesë e bërë nga një anëtar, që del nga deklarata e organit qeverisës, se cilët janë anëtarët me rëndësi të madhe industriale vendoset nga Konferenca, por një kërkesë në Konferencë nuk pezullon zbatimin e deklaratës deri kur Konferenca të vendosë mbi kërkesën.]	3. Me qëllim përmbushjen e kërkesave të paragrafit 2 të këtij neni dhe për të garantuar vazhdimësinë e punës, pesëdhjetë e katër nga pesëdhjetë e gjashtë vende të caktuara përfaqësuesve të qeverive, do të plotësohen si më poshtë: a) Ato duhet të shpërndahen midis katër rajoneve gjeografike (Afrikë, Amerikë, Azi dhe Evropë) për t'u përshtatur, nëse është e nevojshme, me marrëveshje të ndërsjellë midis të gjitha qeverive të interesuara. Secilit prej këtyre rajoneve i caktohet një numër vendesh në bazë të aplikimit të llogaritjes së barabartë të numrit të shteteve anëtare brenda rajonit, popullsisë së tyre të përgjithshme dhe veprimtarisë së tyre ekonomike të vlerësuar nga kriteret e duhura (produkti ose kontributet bruto kombëtare në buxhetin e Organizatës), duke nënkuptuar se asnjë rajon nuk duhet të ketë më pak se dymbëdhjetë vende dhe asnjë nuk duhet të ketë më shumë se pesëmbëdhjetë vende. Për zbatimin e këtij nënparagrafi, shpërndarja fillestare e vendeve do të jetë si më poshtë: Afrika: trembëdhjetë vende; Amerika: dymbëdhjetë vete; Azia dhe Evropa: në mënyrë alternative pesëmbëdhjetë dhe katërmbëdhjetë vende. b) i. gjatë Konferencës Ndërkombëtare të Punës, përfaqësuesit e qeverive që përfaqësojnë shtetet anëtare, të cilat u përkasin rajoneve të ndryshme të referuara në nënparagrafin (a) të këtij paragrafi ose ata që i bashkohen atyre, me marrëveshje të ndërsjellë ose ftohen në Konferencën korresponduese Rajonale, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 4 më poshtë, përbëjnë kolegjet elektorale përgjegjëse për caktimin e anëtarëve për plotësimin e vendeve të caktuara për secilin prej rajoneve të lartpërmendur. Përfaqësuesit e qeverive që përfaqësojnë shtetet e Evropës Perëndimore dhe të atyre që përfaqësojnë shtetet socialiste të Evropës Lindore, përbëjnë kolegje të veçanta

zgjedhore. Ata bien dakord për të ndarë midis tyre vendet e caktuara rajonit dhe përzgjedhin veçmas përfaqësuesit e tyre për organin qeverisës;

ii. kur karakteristikat e veçanta të një rajoni e kërkojnë, qeveritë e atij rajoni mund të bien dakord të formojnë nënndarje mbi bazë nënrajonale për të caktuar veçmas anëtarë, për të plotësuar vendet e caktuara të nënrajonit përkatës;

iii. emërimet i komunikohen kolegjit të përfaqësuesve të qeverive në Konferencë, me qëllim që të shpallë rezultatet. Nëse procesi zgjedhor ose rezultatet e tij në një rajon ose nënrajon i nënshtrohen konfliktit që nuk mund të zgjidhet në këto nivele, kolegji i përfaqësuesve të qeverive në Konferencë do të marrë një vendim në kuadrin e dispozitave të protokollit përkatës.

c) Çdo kolegj zgjedhor ndërmerr hapat e nevojshëm për të garantuar që një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të emëruar për të plotësuar vendet e caktuara atij rajoni, të zgjidhet mbi bazën e madhësisë së popullatës së tyre dhe të garantohet një shpërndarje e barabartë gjeografike, ndërsa në të njëjtën kohë merren parasysh faktorë të tjerë, të tillë si veprimtaria ekonomike e anëtarëve të interesuar, në përputhje me karakteristikat e veçanta të rajonit. Mjetet e zbatimit të këtyre parimeve përcaktohen në protokollet e rëna dakord nga qeveritë e secilit kolegj zgjedhor që do të depozitohen pranë drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

4. Secili prej dy vendeve të mbetura ndahet në mënyrë alternative, për Afrikën dhe Amerikën nga njëra anë dhe për Azinë dhe Evropën nga ana tjetër, me qëllim mundësimin e secilit prej këtyre rajoneve për të garantuar pjesëmarrjen në procesin zgjedhor, mbi bazë jodiskriminuese, të shteteve anëtare që i përkasin atij gjeografikisht ose që i bashkohen me marrëveshje të ndërsjellë, ose ftohen në konferencën korresponduese rajonale, por ende të pambuluar nga protokolli për atë rajon ose nga ndonjë tjetër, duke nënkuptuar se këto shtete nuk do të vendosen në një pozicion të privilegjuar në lidhje me shtetet e krahasueshme në rajon. Kurdoherë që vendi shtesë nuk përdoret në përputhje me dispozitat e mësipërme, duhet të plotësohet nga rajoni i

	interesuar, duke pasur parasysh dispozitat e protokollit të tij.
[4]. Personat që përfaqësojnë punëdhënësit dhe personat që përfaqësojnë punëtorët duhet të zgjidhen përkatësisht nga përfaqësuesit e punëdhënësve dhe përfaqësuesit e punëtorëve në Konferencë.	5. Personat që përfaqësojnë punëdhënësit dhe personat që përfaqësojnë punëtorët duhet të zgjidhen përkatësisht nga përfaqësuesit e punëdhënësve dhe përfaqësuesit e punëtorëve në Konferencë.
[5]. Periudha e qëndrimit në detyrë të organit qeverisës do të jetë tre vjet. Nëse për ndonjë arsye të caktuar, zgjedhjet e organit qeverisës nuk zhvillohen pas skadimit të kësaj periudhe, organi qeverisës do të mbetet në detyrë deri në zhvillimin e këtyre zgjedhjeve.	6. Periudha e qëndrimit në detyrë të organit qeverisës do të jetë tre vjet. Nëse për ndonjë arsye të caktuar, zgjedhjet e organit qeverisës nuk zhvillohen pas skadimit të kësaj periudhe, organi qeverisës do të mbetet në detyrë deri në zhvillimin e këtyre zgjedhjeve.
[6]. Metoda e plotësimit të vendeve vakante dhe të caktimit të zëvendësve dhe çështje të tjera të ngjashme mund të vendosen nga organi qeverisës në bazë të miratimit të Konferencës.	7. Metoda e plotësimit të vendeve vakante dhe e caktimit të zëvendësve dhe çështjeve të tjera të ngjashme mund të vendosen nga organi qeverisës, në bazë të miratimit të Konferencës.
[7]. Organi qeverisës, herë pas here mund të zgjedhë nga numri i vet një kryetar dhe dy nënkryetarë, nga të cilët njëri do të jetë një person që përfaqëson një qeveri, një person që përfaqëson punëdhënësit dhe një person që përfaqëson punëtorët.	8. Organi qeverisës, herë pas here, mund të zgjedhë nga numri i vet një kryetar dhe dy nënkryetarë nga të cilët njëri do të jetë një person që përfaqëson një qeveri, një person që përfaqëson punëdhënësit dhe një person që përfaqëson punëtorët.
[8]. Organi qeverisës rregullon procedurën e vet dhe cakton rastet e tij të takimit. Një takim i veçantë zhvillohet, nëse paraqitet një kërkesë me shkrim për atë qëllim, nga të paktën [gjashtëmbëdhjetë] përfaqësues për organin qeverisës.	9. Organi qeverisës rregullon procedurën e vet dhe cakton rastet e tij të takimit. Një takim i veçantë zhvillohet, nëse paraqitet një kërkesë me shkrim për atë qëllim nga të paktën tridhjetë e dy përfaqësues për organin qeverisës.
Neni 8	Neni 8
1. Duhet të ketë një drejtor të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, i cili do të emërohet nga organi qeverisës i cili caktohet nga organi qeverisës dhe, në bazë të udhëzimeve të organit qeverisës, do të jetë përgjegjës për sjelljen efektive të zyrës dhe për ato detyra të tjera që mund t'i caktohen.	1. Duhet të ketë një drejtor të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, i cili do të emërohet nga organi qeverisës, që duhet të paraqesë emërimin për miratim pranë Konferencës Ndërkombëtare të Punës. 2. Në bazë të udhëzimeve të organit qeverisës, drejtori i përgjithshëm do të jetë përgjegjës për sjelljen efektive të Zyrës dhe për ato detyra të tjera që mund t'i caktohen.
[2]. Drejtori i përgjithshëm ose përfaqësuesi i tij marrin pjesë në mbledhjet e organit qeverisës.	3. Drejtori i përgjithshëm ose përfaqësuesi i tij marrin pjesë në mbledhjet e organit qeverisës.
Neni 13	Neni 13

2. ...

(c) masat për miratim, alokimi dhe arkëtimi i buxhetit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës përcaktohen nga Konferenca me shumicë, prej dy të tretave të votave të paraqitura [nga përfaqësuesit e pranishëm] dhe parashikon miratimin e buxhetit dhe të masave për alokimin e shpenzimeve midis anëtarëve të Organizatës nga një komitet i përfaqësuesve të qeverisë.

4. Një anëtar i Organizatës që ka pagesë të prapambetur të kontributit të tij financiar ndaj Organizatës, nuk ka asnjë votë në Konferencë, në organin qeverisës, në ndonjë komitet ose në zgjedhjet e anëtarëve të organit qeverisës, nëse shuma e detyrimeve të tij të prapambetura është e barabartë ose tejkalon shumën e kontributeve të kërkueshme prej tij për dy vitet e plota pararendëse, me kusht që Konferenca, me shumicën e dy të tretave të votave të paraqitura [nga përfaqësuesit e pranishëm], të mund të lejojë që një anëtar të tillë të votojë, nëse është e bindur se mospagesa është shkaktuar nga kushte përtej kontrollit të anëtarit.

Neni 16

1. Megjithatë, pikat për të cilat është ngritur një kundërshtim i tillë, nuk përjashtohen nga agjenda, nëse [në Konferencë, një shumicë prej dy të tretash të votave të paraqitura nga përfaqësuesit e pranishëm është në favor për shqyrtimin e tyre].

2. Nëse Konferenca vendos (ndryshe se sa sipas paragrafit pararendës) me dy të tretat e votave të paraqitura [nga përfaqësuesit e pranishëm] se ndonjë objekt duhet të shqyrtohet nga Konferenca, ai objekt do të përfshihet në agjendë për [takimin] e ardhshëm.

Neni 17

2. Nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kushtetutë ose sipas kushteve të ndonjë Konvente ose instrumenti tjetër që i jep kompetenca Konferencës ose nga masat financiare dhe buxhetore të miratuara në bazë të nenit 13, të gjitha çështjet do të vendosen me shumicë të thjeshtë të votave të paraqitura [nga përfaqësuesit e pranishëm]

2. ....

c) Masat për miratim, alokimi dhe arkëtimi i buxhetit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës përcaktohen nga Konferenca me shumicë prej dy të tretave të votave të paraqitura dhe parashikon miratimin e buxhetit dhe të masave për alokimin e shpenzimeve midis anëtarëve të Organizatës nga një komitet i përfaqësuesve të qeverisë.

4. Një Anëtar i Organizatës që ka pagesë të prapambetur të kontributit të tij financiar ndaj Organizatës, nuk ka asnjë votë në Konferencë, në organin qeverisës, në ndonjë komitet ose në zgjedhjet e anëtarëve të organit qeverisës, nëse shuma e detyrimeve të tij të prapambetura është e barabartë ose tejkalon shumën e kontributeve të kërkueshme prej tij për dy vitet e plota pararendëse, me kusht që Konferenca, me shumicën e dy të tretave të votave të paraqitura, të mund të lejojë që një anëtar i tillë të votojë, nëse është e bindur se mospagesa është shkaktuar nga kushte përtej kontrollit të anëtarit.

Neni 16

1. Megjithatë, pikat për të cilat është ngritur një kundërshtim i tillë, nuk përjashtohen nga agjenda, nëse Konferenca vendos me shumicë prej dy të tretash të votave të paraqitura, për shqyrtimin e tyre.

2. Nëse Konferenca vendos (ndryshe se sa sipas paragrafit pararendës) me shumicë prej dy të tretave të votave të paraqitura se ndonjë objekt duhet të shqyrtohet nga Konferenca, ai objekt do të përfshihet në agjendë për sesionin e ardhshëm.

Neni 17

2. Nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kushtetutë ose sipas kushteve të ndonjë Konvente ose instrumenti tjetër që i jep kompetenca Konferencës ose nga masat financiare dhe buxhetore të miratuara në bazë të nenit 13, të gjitha çështjet do të vendosen me shumicë të thjeshtë të votave të paraqitura (pro dhe kundër).

3. Në rastet kur Kushtetuta parashikon një

	vendim me shumicë të thjeshtë, vendimi do të miratohet nga të paktën një të tretën e përfaqësuesve që marrin pjesë në sesionin e Konferencës; në rastet kur Kushtetuta parashikon një vendim me shumicë prej dy të tretash, vendimi do të miratohet nga të paktën një të tretën e përfaqësuesve që marrin pjesë në sesion; në rastet kur Kushtetuta parashikon një vendim me shumicë prej tre të katërtave, vendimi do të miratohet nga të paktën tre të tetat e përfaqësuesve që marrin pjesë në sesion.
[3]. Votimi është i pavlefshëm nëse [numri total i votave të paraqitura është i barabartë me gjysmën e numrit të përfaqësuesve që marrin pjesë në Konferencë].	4. Votimi është i pavlefshëm nëse të paktën gjysma e përfaqësuesve që marrin pjesë në sesion dhe që kanë të drejtë për të votuar, nuk kanë marrë pjesë në votim.
Neni 19	Neni 19
2. Në çdo rast, një shumicë prej dy të tretave e votave të paraqitura [nga përfaqësuesit e pranishëm] do të jetë e nevojshme për votën përfundimtare për miratimin e Konventës ose Rekomandimit, sipas rastit, nga Konferenca.	2. Në çdo rast, një shumicë prej dy të tretave e votave të paraqitura do të jetë e nevojshme për votën përfundimtare për miratimin e Konventës ose Rekomandimit, sipas rastit, nga Konferenca.
Neni 21	Neni 21
1. Nëse ndonjë Konventë që paraqitet para Konferencës për shqyrtim përfundimtar, nuk siguron mbështetjen e dy të tretave të votave të paraqitura [nga përfaqësuesit e pranishëm], ajo, megjithatë do të jetë brenda së drejtës së ndonjë prej anëtarëve të Organizatës për të rënë dakord për këtë Konventë midis tyre.	1. Nëse ndonjë Konventë që paraqitet para Konferencës për shqyrtim përfundimtar, nuk siguron mbështetjen e dy të tretave të votave të paraqitura, ajo, megjithatë do të jetë brenda së drejtës së ndonjë prej anëtarëve të Organizatës për të rënë dakord për këtë Konventë midis tyre.
Neni 36	Neni 36
1. Ndryshimet në këtë Kushtetutë që miratohen nga Konferenca me një shumicë prej dy të tretave të votave të paraqitura [nga përfaqësuesit e pranishëm], do të hyjnë në fuqi kur të ratifikohen ose pranohen nga dy të tretat e anëtarëve të Organizatës [duke përfshirë pesë nga dhjetë anëtarët të cilët përfaqësohen në organin qeverisës si anëtarë me rëndësi të madhe industriale, në përputhje me paragrafin 3, të nenit 7 të kësaj Kushtetute].	1. Në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, ndryshimet në këtë Kushtetutë që miratohen nga Konferenca, me një shumicë prej dy të tretave të votave të paraqitura, do të hyjnë në fuqi kur të ratifikohen ose pranohen nga dy të tretat e anëtarëve të Organizatës. 2. Nëse një amendament lidhet me: i. qëllimet themelore të Organizatës, siç përcaktohen në hyrjen e Kushtetutës dhe në deklaratë në lidhje me objektivat dhe qëllimet e Organizatës bashkëlidhur (hyrje; neni 1; shtojca); ii. krijimi i përhershëm i Organizatës, përbërja dhe funksionet e organeve të saj kolegjiale dhe emërimi dhe përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm, siç përcaktohen në Kushtetutë

(neni 1; neni 2; neni 3; neni 4; Neni 7; neni 8; neni 17);

iii. dispozitat kushtetuese në lidhje me Konventat dhe Rekomandimet ndërkombëtare të punës (nenet 19–35; neni 37);

iv. dispozitat e këtij neni,

Nuk do të konsiderohet i miratuar, nëse nuk merr tre të katërtat e votave të paraqitura; nuk do të hyjë në fuqi nëse nuk ratifikohet ose pranohet nga tre të katërtat e anëtarëve të Organizatës.